

V E N D I M
Nr.557, datë 1.8.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I VARREZAVE NË SHARRË, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga rikonstruksioni i varrezave publike në Sharrë, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 880 m2, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 760 000 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shërbime publike", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 147 500 (njëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekësh të përballohet nga Bashkia e Tiranës, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 1-15 gusht 2003.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK PËR
RIKONSTRUKSIONIN E VARREZAVE TË SHARRËS, TIRANË**

Nr.	Emër, mbiemri	Sip.toke m/2	Njësia lekë m/2	Vlera lekë
	Pronarë në bashkëpronësi	805	2000	1 610 000
1	Qamile Hoxha (Muça)			
2	Sanie Kodra (Muça)			
3	Figirete Shima (Muça)			
4	Mude Bakalli (Muça)			
	Pronarë në bashkëpronësi	75	2000	150 000
1	Ike Muça			
2	Sofije Muça			
3	Xhelal Muça			
4	Saniye Muça			
5	Ramiz Muça			
6	Asllan Muça			
7	Qaniye Muça			
8	Bedri Muça			
9	Nexhmije Karaj			
10	Suzana Xhepa			
11	Bujar Muça			

12	Agron Muça			
13	Arben Muça			
				1 760 000